



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 19.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR.1 TË
MARRËVESHJES SË HUAS TË DATËS 31.12.2012, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (EBRD),
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË PËRMIRËSIMIT TË SIGURISË SË DIGËS NË
HIDROCENTRALIN E KOMANIT, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.103/2013”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr.103/2013”, në mbledhjen e datës 19 nëntor 2018.

Të pranishëm në mbledhje ishin përfaqësues të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, përfaqësues të KESH sha-së, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Projektligji synon miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr.1 që mundëson përdorimin e shumës së kursyer nga përfundimi i projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit që arrin në 6,128,224 euro, si dhe zgjerimin e programeve të investimeve në mënyrë që të përfshihen edhe rehabilitimi i portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit.

Marrëveshja bazë e huasë e ratifikuar me ligjin nr.103/2013, miratonte një hua nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim prej 12.7 milionë euro, për të ndihmuar financimin e projektit “Për përmirësimin e sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit” dhe konkretisht programeve të investimeve për fuqizimin e masave për mbrojtjen nga shkëmbinjtë dhe rregullimin e shtratit të rrjedhës dhe zonën e gërryerjes së digës.

Amendimi i marrëveshjes parashikon financimin e rehabilitimit të portave të HEC-it Koman dhe Banka Botërore do të bashkëfinancojë pjesën e mbetur të kësaj kontrate. Për arsye se gjatë zbatimit të projektit fillestar kanë mbetur fonde pa përdorur, nëpërmjet këtij dokumenti ndryshues, këto fonde do të mund të përdoren për të realizuar investime të tjera shtesë.

Konkretisht marrëveshja ndryshuese përmban amendimet e mëposhtme:

- Rishikimin e pjesës A të projektit për përforcimin jo vetëm të zonës së grykës së digës por edhe të zonës në depozitimin e majtë si dhe reduktimin shumës së alokuar për këtë pjesë nga 10 milion euro në rreth 5,620,000 euro.
- Reduktimin e shumës së alokuar të huasë për pjesën B: Fuqizimi i masave për mbrojtjen nga rënia e shkëmbinjve nga 2,573,000 euro që ishte parashikuar në 2013 në rreth 825,201 euro.
- Propozimin e një programi investimi të ri për rehabilitimin e portave të shkarkimit të hidrocentralit, i cili parashikohet të financohet në masën 6,128,224 euro.
- Zgjatjen e afatit të disponueshmërisë së fondeve nga data 31 dhjetor 2016 në 31 dhjetor 2021.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm në mbledhje.

Rakip SULI

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar